



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Numri:** KSC-CC-PR-2020-09

**Vendosi:** Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese  
Gjykatës Vidar Stensland, kryegjykatës  
Gjykatës Roland Dekers  
Gjykatës Antonio Balsamo

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 22 maj 2020

**Gjuha:** Anglishte

**Titulli:** Referimi i ndryshimeve të Rregullores së Procedurës dhe të Provave sipas nenit 19(5) të Ligjit

**Klasifikimi:** Publik

---

### **Aktvendim**

**mbi referimin e ndryshimeve të Rregullores së Procedurës dhe të  
Provave të miratuara nga Plenarja më 29 dhe 30 prill 2020**

---

## Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese

me përbërjen:

Vidar Stensland, kryegjykatës

Roland Dekers, gjykatës

Antonio Balsamo, gjykatës

pas kuvendimeve të zhvilluara nga distanca shqipton Aktvendimin e mëposhtëm.

### I. PROCEDURA

#### A. MIRATIMI DHE RISHIKIMI I RREGULLORES

1. Më 17 mars 2017, gjykatësit e Dhomave të Specializuara të Kosovës të mbledhur në seancë plenare, në përputhje me nenin 19(1) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ('Ligji'), miratuan Rregulloren e Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ('Rregullorja'). Gjykatësit kushtetues nuk morën pjesë në miratimin e saj.

2. Më 27 mars 2017, në përputhje me nenin 19(5) të Ligjit, Kryetarja e Dhomave të Specializuara ("Kryetarja") ia referoi Rregulloren Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ("Dhoma") për të shqyrtuar përputhshmërinë e saj me Kapitullin II të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("Kushtetuta").<sup>1</sup>

3. Më 26 prill 2017, Dhoma vlerësoi se disa nga rregullat nuk ishin në përputhje me Kapitullin II të Kushtetutës dhe se në lidhje me një rregull nuk mund të nxirrte konstatim për përputhshmëri. Dispozitat e tjera nuk ishin në mospërputhje me

---

<sup>1</sup> KSC-CC-PR-2017-01, F00001, Referimi i Rregullores së Procedurës dhe të Provave Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, publik, 27 mars 2017.

Kapitullin II të Kushtetutës.<sup>2</sup> Konstatimet e Dhomës iu dërguan gjykatësve të Plenares për të ndërmarrë veprim në lidhje me rregullat përkatëse.

4. Më 29 maj 2017, gjykatësit e mbledhur në Plenare miratuan rregullat e rishikuara të Rregullores. Kryetarja më pas ia referoi Rregulloren Dhomës për shqyrtim sipas nenit 19(5) të Ligjit.<sup>3</sup> Më 28 qershor 2017, Dhoma konstatoi se Rregullorja ishte në përputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.<sup>4</sup> Rrjedhimisht, Rregullorja hyri në fuqi më 5 korrik 2017 në përputhje me rregullën 1(3) të Rregullores.

#### B. NDRYSHIMET E RREGULLORES

5. Më 29 dhe 30 prill 2020, gjykatësit e Dhomave të Specializuara të Kosovës të mbledhur në seancë plenare, miratuan ndryshime të 30 rregullave të Rregullores.<sup>5</sup> Si rregull, gjykatësit kushtetues nuk morën pjesë në miratimin e tyre.

#### C. REFERIMI I NDRYSHMEVE

6. Më 1 maj 2020, Kryetarja ia referoi Dhomës ndryshimet e lartpërmendura ("Referimi"), në përputhje me nenin 19(5) të Ligjit.<sup>6</sup> Në të njëjtën ditë, në përputhje me nenin 33(3) të Ligjit, Kryetarja caktoi panelin me përbërjen si më lart për të shqyrtuar

---

<sup>2</sup> KSC-CC-PR-2017-01, F00004, Aktvendim mbi Referimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave miratuar nga Plenarja më 17 mars 2017, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 19(5) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, publik, 26 prill 2017 ("Aktvendimi i 27 prillit 2017").

<sup>3</sup> KSC-CC-PR-2017-03, F00001, Referimi i Rregullave të Rishikuara të Rregullores së Procedurës dhe të Provave Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, publik, 31 maj 2017.

<sup>4</sup> KSC-CC-PR-2017-03, F00006, COR, Aktvendim mbi Referimin e Rregullave të Rishikuara të Rregullores së Procedurës dhe të Provave miratuar nga Plenarja më 29 maj 2017, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 19(5) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, publik, 28 qershor 2017 ("Aktvendimi i 28 qershorit 2017").

<sup>5</sup> KSC-CC-PR-2020-09, F00001, Referimi i ndryshimeve të Rregullores së Procedurës dhe të Provave drejtuar Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, publik me shtojcë konfidenciale, 1 maj 2020 ("Referimi"), para. 1.

<sup>6</sup> Po aty.

ndryshimet, për të garantuar përputhshmërinë e tyre me Kapitullin II, përfshirë nenin 55, të Kushtetutës.<sup>7</sup>

7. Në vijim Dhoma do të kalojë në vlerësimin e Referimit.

## II. JURIDIKSIONI

8. Në lidhje me juridiksionin e saj për të marrë vendim mbi Referimin, Dhoma thekson se në bazë të nenit 162(6) të Kushtetutës, Dhoma ka kompetencë për shqyrtimin e Rregullores për të garantuar përputhshmërinë e saj me Kapitullin II të Kushtetutës. Më tej, sipas nenit 19(5) të Ligjit, Dhoma shqyrton ndryshimet e miratuara të Rregullores. Kjo përcaktohet edhe në rregullat 4(a) dhe 13(1) të Rregullores së Punës të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese.

9. Nga kjo rrjedh se Dhoma ka juridiksion për shqyrtimin e këtij Referimi të ndryshimeve të Rregullores.<sup>8</sup>

## III. PRANUESHMËRIA

10. Dhoma thekson se sipas rregullës 4(a) të Rregullores së Punës të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, ndryshimet e Rregullores i referohen Dhomës prej Kryetarit. Kjo përcaktohet edhe në rregullën 7(6) të Rregullores. Në këtë çështje, Kryetarja ia referoi Dhomës ndryshimet e miratuara nga Plenarja në pajtim me nenin 19(4) të Ligjit.

11. Në përputhje me sa më lart, Referimi është i pranueshëm. Rrjedhimisht, Dhoma në vijim do të shqyrtojë ndryshimet.<sup>9</sup>

---

<sup>7</sup> KSC-CC-PR-2020-09, F00002, Vendim për caktimin e panelit të Gjykatës Kushtetuese të Dhomave të Specializuara, publik, 1 maj 2020.

<sup>8</sup> Shih Aktvendimin e 28 qershorit 2017, para. 7, 10, 12.

<sup>9</sup> Shih po aty, para. 7, 12.

#### IV. VLERËSIMI

##### A. SHTRIRJA E SHQYRTIMIT

12. Pikësëpari, Dhoma rithekson se në përputhje me nenin 162(6) të Kushtetutës dhe nenin 19(5) të Ligjit, ky shqyrtim kufizohet vetëm në aspektin nëse ndryshimet e Rregullores ashtu sikurse janë formuluar, janë në përputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.<sup>10</sup>

13. Dhoma nuk ka për detyrë të përcaktojë se si mund të përmirësohet Rregullorja, e as të parashikojë skenarë të mundshëm në lidhje me zbatimin e saj. Faktikisht, mënyra e zbatimit të një dispozite konkrete mund të jetë thelbësore për garantimin e përputhshmërisë me Kapitullin II të Kushtetutës. Gjatë interpretimit dhe zbatimit të Rregullores është thelbësore që të mbahen parasysh neni 162(2) i Kushtetutës dhe neni 3(2)(a) dhe (e) i Ligjit, të cilët kërkojnë që Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar të funksionojnë në përputhje me të drejtat dhe liritë themelore të mishëruara në Kapitullin II të Kushtetutës.<sup>11</sup>

##### B. PARIMET UDHËZUESE

14. Dhoma rikujton parimin e përcaktuar në jurisprudencën e saj se, për shqyrtimin e Rregullores, Dhoma duhet të niset prej nenit 19(2) të Ligjit sipas të cilit Rregullorja “pasqyron standardet më të larta të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut [...]”. Në këtë kontekst, Dhoma pranon se gjykatësit e mbledhur në Plenare kishin për qëllim përmbushjen e standardeve më të larta të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.<sup>12</sup>

15. Rrjedhimisht, insinuatat e papërfillshme apo hamendësimet e mjegullta nuk paraqesin arsye të vlefshme mbi të cilat kjo Dhomë mund të bazojë konstatimin se një dispozitë e Rregullores është në mospërputhje me Kapitullin II të Kushtetutës. Një

---

<sup>10</sup> Aktvendimi i 26 prillit 2017, para. 10.

<sup>11</sup> Shih po aty, para. 11; Aktvendimi i 28 qershorit 2017, para. 14-15.

<sup>12</sup> Aktvendimi i 26 prillit 2017, para. 12.

konstatim të tillë Dhoma nxjerr vetëm kur mospërputhshmëria e një dispozite është e qartë nga vetë formulimi i dispozitës. Dhoma nuk arrin lehtë në një konstatim të tillë.<sup>13</sup>

16. Më tej, Dhoma bazohet në parimin e interpretimit harmonik. Ajo nuk interpreton një rregull më vete, por në kontekstin e rregullave të tjera dhe dispozitave përkatëse të Ligjit, me qëllim harmonizimin e rregullave. Në vlerësimin e vet nëse një dispozitë e interpretuar në atë mënyrë është në përputhje me të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kapitullin II të Kushtetutës, Dhoma bazohet në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“GJEDNJ”) duke qenë se në pajtim me nenin 53 të Kushtetutës, Dhoma ka për detyrë t’i interpretojë të drejtat dhe liritë themelore në përputhje me vendimet e GJEDNJ-së.<sup>14</sup> Në këtë kontekst, Dhoma thekson deklaratën e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës se “Gjykata Kushtetuese është e obliguar që të interpretojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore në përputhje me vendimet gjyqësore të [GJEDNJ-së]”.<sup>15</sup>

17. Kur një dispozitë nuk ngre probleme të përputhshmërisë me Kapitullin II të Kushtetutës, Dhoma nuk bën komente në lidhje me atë dispozitë. Kur një dispozitë ngre një çështje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara në Kapitullin II të Kushtetutës, ajo dispozitë shqyrtohet në imtësi dhe tërësi, për të përcaktuar përputhshmërinë e përgjithshme të saj me Kapitullin II të Kushtetutës.<sup>16</sup>

---

<sup>13</sup>Po aty, para. 12-13, 17.

<sup>14</sup> Shih po aty, para. 14, 16 në fund; KSC-CC-2019-05, F00012, Vendim mbi Referimin e Mahir Hasanit në lidhje me urdhrin e Prokurorisë të 20 dhjetorit 2018, publik, 20 shkurt 2019 (“Vendim mbi Referimin e Mahir Hasanit”), para. 25.

<sup>15</sup> Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Pml. nr. 181/15, të 6 nëntorit 2015*, KI 43/16, Aktvendim për Pranueshmëri, 14 prill 2016 (16 maj 2016), para. 50. Shih gjithashtu Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Gëzim dhe Makfire Kastrati kundër Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës*, KI 41/12, Aktgjykim, 25 janar 2013 (26 shkurt 2013), para. 58.

<sup>16</sup> Aktvendimi i 26 prillit 2017, para. 15-16.

18. Duke u nisur nga sa më lart, Dhoma në vijim do të kalojë në shqyrtimin e ndryshimeve të Rregullores. Në këtë Aktvendim citohet teksti i rregullave të ndryshuara në formën që i janë dorëzuar Dhomës për shqyrtim.<sup>17</sup>

## V. NDRYSHIMET

19. Duke u kushtuar rëndësinë e duhur parimeve udhëzuese të lartpërmendura, Dhoma gjykon se ndryshimet e mëposhtme kërkojnë një analizë më të hollësishme.

### A. NDRYSHIMET E RREGULLËS 31

20. Në rregullën 31 të ndryshuar, në formën që i është dorëzuar Dhomës për shqyrtim, lexohet si vijon:

#### **Rregulla 31 Garanci minimale të përgjithshme**

(1) – (2) [të pandryshuar]

(3) Informacioni që buron prej marrëdhënies profesionale **të një personi me mbrojtësin e vet të specializuar apo marrëdhënie tjetër konfidenciale** përcaktuar në rregullën 111-(1)- konsiderohet i mbrojtur dhe nuk është objekt i masave hetimore, përveçse kur statusi i mbrojtur keqpërdoret për të kryer një vepër penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara dhe provat që kërkohen, kanë kontribuar në kryerjen e asaj vepre penale. Në një rast të tillë, rregulla 33 (1)(a)(ii) zbatohet *mutatis mutandis*.

(4) Informacioni që buron prej çfarëdo marrëdhënieje tjetër profesionale apo konfidenciale sikurse përcaktohet në rregullën 111(2) - (3) nuk është objekt i masave hetimore, përveçse kur një panel vendos ndryshe duke u bazuar në rrethanat e rastit. Në një rast të tillë, rregulla 33 (1)(a)(ii) zbatohet *mutatis mutandis*.

### 1. Reflektime paraprake

21. Dhoma vëren se me këto ndryshime të paragrafëve (3) dhe (4) të rregullës 31, Plenarja ka marrë parasysh vërejtjet e Dhomës të bëra në Aktvendimin e 28 qershorit 2017.

22. Dhoma rikujton se në Aktvendimin e 28 qershorit 2017, Dhoma theksoi se Plenarja kishte zgjeruar një ndalim thuajse të përgjithshëm ndaj zbatimit të masave

<sup>17</sup> KSC-CC-PR-2020-09, F00001, A01, Shtojcë, konfidenciale, 1 maj 2020.

hetimore në lidhje me informacionin e siguruar jo vetëm në kontekstin e marrëdhënies avokat-klient por gjithashtu edhe në kontekstin e marrëdhënieve të tjera profesionale ose konfidenciale, siç përcaktohet në rregullën 111. Dhoma u shpreh se një ndalim i tillë thuajse i përgjithshëm lidhur me informacionin që buron prej marrëdhënieve të tjera profesionale apo konfidenciale mund të kufizojë në mënyrë të palejueshme Prokurorin e Specializuar në kryerjen e funksioneve të veta të parapara me Ligj. Dhoma gjykoi se i takon një paneli kompetent që të vlerësojë në bazë të rrethanave të secilit rast nëse do të zbatohen masa hetimore në lidhje me marrëdhënie të tjera profesionale apo konfidenciale.<sup>18</sup>

23. Duke marrë parasysh vërejtjet e lartpërmendura të Dhomës, në rregullën 31 Plenarja tani ka parashikuar mundësinë që një panel të vlerësojë në bazë të rrethanave të secilit rast nëse mund të zbatohen masat hetimore të parapara në Rregullore në lidhje me informacionin që buron prej çfarëdo marrëdhënieje tjetër profesionale apo konfidenciale sikurse përcaktohet në rregullën 111(2) dhe (3). Në këtë mënyrë, ndryshimet e paragrafëve (3) dhe (4) të rregullës 31 duhen interpretuar në kontekstin e rregullave të tjera lidhur me masat hetimore, ndër të cilat paragrafi (1) i rregullës 31 për garancitë minimale të përgjithshme. Dhoma rikujton konstatimin e saj se këto rregulla janë në përputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.<sup>19</sup> Rrjedhimisht, ndryshimet e rregullës 31 Dhoma do t'i vlerësojë në atë kontekst.

## 2. Vlerësimi i Dhomës

### (a) Parimet udhëzuese

24. Sikurse theksohet në Aktvendimin e Dhomës të 26 prillit 2017, zbatimi i masave hetimore ku gjithashtu përfshihen masat e posaçme hetimore dhe kontrollimi e sekuestrimi, përgjithësisht lidhet me të drejtën për integritet personal dhe të drejtën për privatësi të garantuara në nenet 26 dhe 36 të Kushtetutës dhe nenin 8 të Konventës

---

<sup>18</sup> Shih Aktvendimin e 28 qershorit 2017, para. 21-25.

<sup>19</sup> Shih po aty, para. 29-89.



Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“Konventa”).<sup>20</sup> Ndonëse zbatimi i masave hetimore mund të lidhet gjithashtu edhe me të drejta të tjera kushtetuese, si për shembull të drejtat e të akuzuarit dhe e drejta për gjykim të drejtë përcaktuar në nenet 30 dhe 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës,<sup>21</sup> në këtë shqyrtim Dhoma ka për detyrë të vlerësojë vetëm formulimin e ndryshimeve lidhur me përputhshmërinë e tyre me Kapitullin II të Kushtetutës (shih paragrafët 12 dhe 15 më lart).

25. Dhoma vëren se këto ndryshime ashtu sikurse janë formuluar, parashikojnë mundësinë për sigurimin nëpërmjet masave hetimore, të informacionit që buron nga marrëdhëniet profesionale apo konfidenciale që një person mund të ketë me mjekun, psikologun ose këshillëdhënësin e vet. Informacioni që personi u komunikon profesionistëve të tillë më së shpeshti ka të bëjë me çështje intime dhe personale. Për këtë arsye, mundësia e sigurimit të të dhënave të tilla në bazë të rregullës 31, ashtu sikurse është ndryshuar, lidhet drejtpërsëdrejti me të drejtën për privatësi të përcaktuar në nenin 36 të Kushtetutës dhe nenin 8 të Konventës, madje edhe kur të dhëna të tilla mund të sigurohen vetëm nga Zyra e Prokurorit të Specializuar.<sup>22</sup> Rrjedhimisht, Dhoma duhet të vlerësojë nëse ndryshimet e rregullës 31 janë në përputhje me të drejtën për respektimin e privatësisë.

26. Sikurse u konstatua në Aktvendimin e Dhomës të 26 prillit 2017, nga neni 55 i Kushtetutës dhe neni 8(2) i Konventës rrjedh se çdo ndërhyrje në të drejtën për privatësi të përcaktuar në nenin 36 të Kushtetutës dhe nenin 8(1) të Konventës mund të përliqet vetëm nëse është ‘në përputhje me ligjin’ dhe ‘e domosdoshme’ në një

<sup>20</sup> Aktvendimi i 26 prillit 2017, para. 60, 77.

<sup>21</sup> Shih *Vendim mbi Referimin e Mahir Hasanit*, para. 27-28; KSC-CC-2019-07, F00013, Vendim mbi kërkesën referuese të Driton Lajçit në lidhje me procedurën e marrjes në pyetje nga Zyra e Prokurorit të Specializuar, publik, 13 janar 2020 (“*Vendim mbi kërkesën referuese të Driton Lajçit*”), para. 13-15.

<sup>22</sup> Shih ECtHR/GJEDNJ, *Avilkina and Others v. Russia*, nr. 1585/09, 6 qershor 2013, para. 32; *Z v. Finland*, 25 shkurt 1997, Raporte Aktgjykimesh dhe Vendimesh 1997-I, para. 70-71; *Panteleyenko v. Ukraine*, nr. 11901/02, 29 qershor 2006, para. 57-58.

shoqëri të hapur dhe demokratike për përmbushjen e qëllimeve të përcaktuara në Kushtetutë.<sup>23</sup>

27. Për sa i përket kushtit 'në përputhje me ligjin', kjo do të thotë se një masë duhet të ketë bazën e vet në ligj dhe të jetë në përputhje me shtetin ligjor. Rrjedhimisht, Ligji duhet të jetë i disponueshëm dhe i parashikueshëm në masën e duhur, që do të thotë i formuluar me saktësi të mjaftueshme për t'i mundësuar personit – sipas nevojës me anë të këshillave përkatëse – të rregullojë sjelljen dhe veprimet e veta. Ligji duhet të përcaktojë me qartësi të mjaftueshme fushëveprimin e kompetencave që u jep autoriteteve kompetente dhe mënyrën e ushtrimit të tyre, në mënyrë që t'i mundësojë personit mbrojtjen e duhur nga ndërhyrja arbitrare.<sup>24</sup>

28. Duke qenë se ligjshmëria e ndërhyrjes lidhet ngushtë me 'domosdoshmërinë' e ndërhyrjes, këto dy kritere Dhoma do t'i shqyrtojë bashkërisht.<sup>25</sup>

(b) Zbatueshmëria e parimeve

29. Fillimisht, Dhoma vëren se rregulla 31 ashtu sikurse është ndryshuar, konfirmon qartësisht se disa kategori komunikimesh të përcaktuara në rregullën 111(3) konsiderohen të privileguara, përkatësisht komunikimet midis një personi dhe mjekut, psikologut, ose këshillëdhënësit të tij, midis një personi dhe një kleriku, si edhe komunikimet e bëra në kontekstin e rrëfimit të shenjtë. Ndryshimet gjithashtu konfirmojnë se edhe komunikimet e bëra në kontekstin e marrëdhënieve të tjera profesionale ose konfidenciale që plotësojnë kushtet e rregullës 111(2), konsiderohen të privileguara.

<sup>23</sup> Shih Aktvendimin e 26 prillit 2017, para. 54, 61. Shih ECtHR/GJEDNJ, *Panteleyenko v. Ukraine*, cituar më lart, para. 48, 59.

<sup>24</sup> Aktvendimi i 26 prillit 2017, para. 62-63, 90. Shih Aktvendimin e 28 qershorit 2017, para. 34; ECtHR/GJEDNJ, *Avilkina and Others v. Russia*, cituar më lart, para. 35; *Y.Y. v. Russia*, nr. 40378/06, 23 shkurt 2016, para. 49; *G.S.B. v. Switzerland*, nr. 28601/11, 22 dhjetor 2015, para. 68; *L.H. v. Latvia*, nr. 52019/07, 29 prill 2014, para. 47.

<sup>25</sup> Shih Aktvendimin e 26 prillit 2017, para. 64; ECtHR/GJEDNJ, *R.E. v. the United Kingdom*, nr. 62498/11, 27 tetor 2015, para. 157 *in fine*; *Avilkina and Others v. Russia*, cituar më lart, para. 37.

30. Në lidhje me sa më lart, Dhoma vëren se rregulla 111(3) nuk përfshin komunikimet, për shembull, me gazetarë. Njëherësh, zbatimi i masave hetimore lidhur me informacionin që buron nga kontaktet me gazetarë mund të ngrejë edhe çështje të së drejtës së lirisë së shprehjes dhe rrjedhimisht kërkon një analizë sa më të kujdesshme.<sup>26</sup> Për këtë arsye, rregulla 31(4) ashtu sikurse është ndryshuar, mund të jetë relevante edhe lidhur me marrëdhënie të tjera profesionale të cilat, megjithëse nuk përmenden shprehimisht në rregullën 111(3), mund t'i plotësojnë kushtet e rregullës 111(2).

31. Dhoma më tej vëren se rregulla 31 ashtu sikurse është ndryshuar, përmban një garanci të rëndësishme për mbrojtjen e informacionit që buron prej marrëdhënieve profesionale ose konfidenciale të lartpërmendura të përcaktuara në rregullën 111(2) dhe (3). Në veçanti, ky informacion si parim nuk mund të jetë objekt i masave hetimore. Masat hetimore lidhur me një informacion të tillë mund të zbatohen vetëm me autorizimin e një paneli.

32. Për më tepër, fraza se për “masa hetimore” nevojitet vendim i një paneli do të thotë se autorizim paraprak gjyqësor duhet jo vetëm për masa hetimore të posaçme apo kontrollime dhe sekuestre, por edhe për çfarëdo mase tjetër hetimore lidhur me informacionin që buron prej marrëdhënieve të tjera profesionale ose konfidenciale të përcaktuara në rregullën 111(2) dhe (3). Kjo gjithashtu do të thotë se edhe në rrethana të ngutshme si ato që përshkruhen në rregullën 36 dhe rregullën 38, Prokurori i Specializuar nuk mund të veprojë pa autorizimin e masës përkatëse prej një paneli.

33. Rregulla 31(1)(b) gjithashtu garanton që zbatimi i masave hetimore në lidhje me informacionin që buron prej marrëdhënieve profesionale ose konfidenciale të lartpërmendura mund të merret parasysh vetëm nëse dhe për aq sa informacioni

---

<sup>26</sup> Shih, për shembull, ECtHR/GJEDNJ, *Roemen and Schmit v. Luxembourg*, nr. 51772/99, ECHR 2003-IV; *Telegraaf Media Nederland Landelijke Media B.V. and Others v. the Netherlands*, nr. 39315/06, 22 nëntor 2012.

përkatës është *i domosdoshëm* për hetimin. Për aq sa rregullat e tjera përcaktojnë kushte të mëtejshme për ndërmarrjen e llojeve të caktuara të masave hetimore, Dhoma rikujton konstatimet e bëra në Aktvendimin e 28 qershorit 2017 mbi përputhshmërinë e tyre me Kapitullin II të Kushtetutës, si dhe me kushtin e ‘në përputhje me ligjin’ dhe të ‘domosdoshmërisë’.<sup>27</sup>

34. Rrjedhimisht, krahas kufizimeve dhe garancive ekzistuese të përfshira në dispozitat e tjera për masat hetimore, ndër të tjera edhe në rregullën 31, ndryshimet e rregullës 31(4) kërkojnë që një panel të vlerësojë në bazë të rrethanave të secilit rast nëse një masë hetimore e caktuar mund të përliqet duke pasur parasysh natyrën e marrëdhënies përkatëse.

35. Në këtë kontekst, Dhoma konfirmon se masat hetimore lidhur me informacionin që buron prej marrëdhënieve të përcaktuara në rregullën 111(2) dhe (3) dhe është *i domosdoshëm* për hetimin e veprave penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara, në parim mund të shërbejnë për realizimin e qëllimeve legjitime të parandalimit të veprës penale dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të tjerëve të përcaktuara në nenin 36 të Kushtetutës dhe nenin 8(2) të Konventës.<sup>28</sup>

36. Njëherazi, mbrojtja e informacionit personal, posaçërisht lidhur me shëndetin e një personi, është me rëndësi thelbësore për gëzimin e të drejtës për respektimin e privatësisë. Nxjerrja e informacionit të ndjeshëm personal mund të ketë ndikim dramatik në jetën e një personi. Respektimi i konfidencialitetit të informacionit personal është një parim jetik. Është shumë e rëndësishme jo vetëm që të respektohet ndjenja e privatësisë së një personi por edhe të ruhet besimi i atij personi në profesionet e përmendura në rregullën 31(4), ndër të cilat edhe ai mjekësor.

37. Për sa u përket veçanërisht shërbimeve shëndetësore, Dhoma rithekson se pa një mbrojtje të tillë, ata që kanë nevojë për ndihmë mjekësore mund të detyrohen të mos

---

<sup>27</sup> Shih Aktvendimin e 28 qershorit 2017, para. 29-89.

<sup>28</sup> Shih *Z v. Finland*, cituar më lart, para. 76.

zbulojnë informacion të natyrës personale dhe intime që mund të jetë i nevojshëm për trajtimin e duhur mjekësor të tyre, dhe madje edhe të mos kërkojnë ndihmë mjekësore, me çka e venë në rrezik shëndetin e tyre dhe në disa raste edhe atë të shoqërisë.<sup>29</sup>

38. Për këtë arsye, është me rëndësi thelbësore që kur vlerëson zbatueshmërinë e masave hetimore në bazë të rregullës së ndryshuar 31(4), paneli të shqyrtojë me imtësi kriteret e domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit në mënyrë që të parandalohet çdo ndërhyrje e papërligjur në të drejtën për respektimin e privatësisë. Varësisht nga informacioni që kërkohet, interesi për të mbrojtur konfidencialitetin e tij mund të peshojë më shumë gjatë përcaktimit nëse ndërhyrja është proporcionale me qëllimin legjitim që kërkohet të arrihet. Një ndërhyrje e tillë nuk mund të jetë e pajtueshme me nenet 36 dhe 55 të Kushtetutës dhe nenin 8 të Konventës, përveçse kur përlligjet nga një kërkesë madhore e interesit publik.

39. Në lidhje me këtë, Dhoma gjithashtu thekson se në përputhje me rrethanat konkrete të secilit rast, mund të jetë e përshtatshme që paneli të kërkojë mendimin e personit përkatës ose të zbatojë garanci mbrojtëse të tjera që mund të jenë të nevojshme për garantimin e përputhshmërisë së ndërhyrjes me garancitë në nenet 36 dhe 55 të Kushtetutës dhe nenin 8 të Konventës.<sup>30</sup>

40. Për sa u përket garancive mbrojtëse të tjera që mund të jenë të nevojshme, Dhoma vëren se rregulla 31(4) e ndryshuar, ashtu sikurse i është parashtruar Dhomës për vlerësim, nuk përmban formulimin aktualisht në fuqi se “[s]ipas nevojës, paneli mund të përcaktojë edhe garanci të tjera mbrojtëse”. Me sa duket ky formulim është fshirë. Gjithsesi, kjo nuk e pengon një panel që të përcaktojë garanci të tjera mbrojtëse.

---

<sup>29</sup> Shih ECtHR/GJEDNJ, *Avilkina and Others v. Russia*, cituar më lart, para. 45; *Z v. Finland*, cituar më lart, para. 95-96; *Biriuk v. Lithuania*, nr. 23373/03, 25 nëntor 2008, para. 39, 43; *Y.Y. v. Russia*, cituar më lart, para. 38; *Y v. Turkey* (dec.), nr. 648/10, 17 shkurt 2015, para. 68.

<sup>30</sup> Shih ECtHR/GJEDNJ, *Z v. Finland*, cituar më lart, para. 96-97, 101 *et seq.*; *Avilkina and Others v. Russia*, cituar më lart, para. 47-48. Shih gjithashtu *Sidorova v. Russia*, nr. 35722/15, 28 maj 2019, para. 33.

41. Në këtë kontekst, është me rëndësi që rregulla 31(4), ashtu sikurse është ndryshuar, lidhet me informacionin që buron prej një sërë marrëdhëniesh të tjera profesionale dhe konfidenciale të përcaktuara në rregullën 111(2) dhe (3). Për këtë arsye, është praktikisht e pamundur të përcaktohen paraprakisht garancitë mbrojtëse konkrete të cilat mund të jenë të nevojshme për çdo skenar që mund t'i paraqitet një paneli.<sup>31</sup> Kjo do të varet nga rrethanat konkrete të secilit rast të cilat paneli do t'i shqyrtojë me kujdes në imtësi dhe tërësi, duke u kushtuar vëmendjen e duhur kushteve të domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit të masës, sikurse parashikohet gjithashtu edhe në rregullën 31(1)(b) dhe (c) të zbatueshme lidhur me të gjitha masat hetimore.<sup>32</sup>

42. Duke marrë parasysh sa më lart, Dhoma gjykon se ndryshimet e rregullës 31, të interpretuara në kontekstin e rregullave të tjera për masat hetimore për të cilat tashmë është konstatuar se janë në përputhje me Kapitullin II të Kushtetutës, përcaktojnë kufizime të rëndësishme mbi zbatimin e masave hetimore lidhur me informacionin e siguruar në kontekstin e marrëdhëniesh të tjera profesionale dhe konfidenciale të përcaktuara në rregullën 111(2) dhe (3), dhe se masa të tilla hetimore shoqërohen me garancitë mbrojtëse përkatëse kundër keqpërdorimit.

### 3. Konstatim

43. Në varësi të respektimit të parimeve të shtjelluara më lart dhe duke mbajtur parasysh detyrimin e Dhomave të Specializuara për të funksionuar në përputhje me nenin 162(2) të Kushtetutës dhe nenin 3(2) të Ligjit, Dhoma konstaton se ndryshimet e rregullës 31 janë në përputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.

#### B. NDRYSHIMET E RREGULLËS 38

---

<sup>31</sup> Lidhur me këtë, shih ECtHR/GJEDNJ, *Avilkina and Others v. Russia*, cituar më lart, para. 35 në fund.

<sup>32</sup> Aktvendimi i 28 qershorit 2017, para. 30, 32-33, 35.

44. Në rregullën 38 të ndryshuar, ashtu sikurse i është parashtruar Dhomës për shqyrtim, lexohet si vijon:

**Rregulla 38 Kontrollimi dhe sekuestrimi prej Prokurorit të Specializuar**

Bazuar në nenin 35 dhe nenin 39 të Ligjit, Prokurori i Specializuar, pa autorizimin e një paneli, mund të kryejë kontrollimin e një personi ose prone, vendi, mjediseve apo objekti, dhe të sekuestrojë përkohësisht çfarëdo sendi të gjetur gjatë kontrollimit sipas kushteve të përcaktuara në rregullën 37 (1) dhe (3), në qoftë se:

(a) [i pandryshuar];

(b) [i pandryshuar]; ~~ose~~

(c) [i pandryshuar]; ~~ose~~

**(d) është e nevojshme mbledhja e provave që rrezikohen të humbasin.**

45. Sikurse me ndryshimet e rregullës 31 të shqyrtuara më lart, Dhoma vëren se edhe me ndryshimet e rregullës 38(d) Plenarja ka marrë parasysh vërejtjet e Dhomës të bëra në Aktvendimin e 28 qershorit 2017.

46. Dhoma rikujton se në Aktvendimin e 28 qershorit 2017, ajo theksoi se kjo rregull parashtron rrethanat në të cilat Prokurori i Specializuar mund të kryejë kontrollim dhe sekuestrim pa autorizim gjyqësor paraprak. Sidoqoftë, kjo dispozitë nuk përcaktonte rrethanat kur ekziston “rreziku i humbjes së provave, në qoftë se nuk kryhet një operacion i menjëhershëm kontrollimi dhe sekuestrimi”, edhe pse mund të jetë e nevojshme që Prokurori i Specializuar të veprojë në një situatë të tillë me qëllim që të përmbushë detyrimet e veta ligjore. Baza ligjore e kompetencës së Prokurorit të Specializuar për kryerjen e një operacioni në rrethana të tilla pa autorizim gjyqësor paraprak gjendet në nenin 36(2) të Kushtetutës. Në lidhje me këtë, Dhoma gjithashtu u mbështet në nenin 110(3) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës nr. 04/L-123 (“KPPK”), ku përcaktohet kjo kompetencë e prokurorisë.<sup>33</sup>

47. Nga kjo rrjedh se që në Aktvendimin e vet të 28 qershorit 2017, Dhoma njohu këtë bazë ligjore, e paraqitur aktualisht në ndryshimet e rregullës 38(d), për kryerjen

<sup>33</sup> Aktvendimi i 28 qershorit 2017, para. 73-76.

e kontrollimit dhe sekuestrimit pa autorizim gjyqësor paraprak. Rrjedhimisht, Dhoma nuk ka nevojë të bëjë vlerësim të hollësishëm të këtyre ndryshimeve. Njëherazi, Dhoma e gjykon të përshtatshme të nënvizojë sa vijon.

48. Rregulla 38(d) e ndryshuar nuk specifikon që Prokurori i Specializuar mund të veprojë pa autorizim gjyqësor paraprak në rastet kur ekziston rrezik i humbjes së provave *po qe se* nuk kryhet menjëherë kontrollim dhe sekuestrimit, sikurse theksoi Dhoma në Aktvendimin e 28 qershorit 2017 (shih paragrafin 46 më lart). Në vend të kësaj, rregulla 38(d), ashtu sikurse është ndryshuar, u referohet “provave që rrezikohen të humbasin”. Gjithsesi, edhe në rast të provave që rrezikohen të humbasin mund të ketë kohë të mjaftueshme për të kërkuar autorizim gjyqësor paraprak në përputhje me rregullën 37.

49. Në këtë kontekst, Dhoma thekson se autorizimi gjyqësor paraprak është një garanci mbrojtëse e rëndësishme kundrejt ndërhyrjes së papërligjtur në të drejtën për respektimin e privatësisë të përcaktuar në nenet 36 dhe 55 të Kushtetutës dhe nenin 8 të Konventës. Për këtë arsye ai duhet të kërkohet kur është e mundshme, pa rrezikuar humbjen e provave.

50. Duke mbajtur parasysh vërejtjet e mësipërme, Dhoma konstaton se ndryshimet e rregullës 38 janë në përputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.

#### C. NDRYSHIMET E RREGULLËS 42

51. Në rregullën 42 të ndryshuar, ashtu sikurse i është parashtruar Dhomës për shqyrtim, lexohet si vijon:

##### **Rregulla 42 Dispozitë e përgjithshme**

**(1)** Gjatë hetimit që kryen Prokurori i Specializuar, një person:

(a) **nuk detyrohet të pranojë fajësinë e as detyrohet të dëshmojë kur dëshmia mund të inkriminojë atë apo personat e përmendur në rregullën 152;**

(b) – (d) [të pandryshuar]



(2) Prokurori i Specializuar informon personin për të drejtat e tij të përmendura në paragrafin (1) në një gjuhë që ai person kupton.

(3) Çdo kundërshtim që paraqitet në lidhje me fletëthirrjet, urdhrat ose veprimet hetimore të Prokurorit të Specializuar mbi bazën se ndikojnë negativisht në të drejtat e një personi, i paraqitet një gjykatësi të vetëm i cili caktohet sipas nenit 25(1)(f) të Ligjit, nëse nuk është caktuar panel. Kundërshtime të tilla paraqiten jo më vonë se një muaj nga njoftimi zyrtar për fletëthirrje, urdhra apo veprime hetimore të tilla dhe nga konfirmimi i personit në fjalë për vënien në dijeni.

## 1. Reflektime paraprake

52. Dhoma vëren se rregulla 42(1)(a), ashtu sikurse është ndryshuar, përcakton ndër të tjera privilegjin e mosinkriminimit të vetvetes. Në këtë kontekst, ajo ka të bëjë me të drejtën kushtetuese të një personi që ‘akuzohet për veprë penale’, brenda kuptimit të nenit 30 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës,<sup>34</sup> për të heshtur dhe të drejtën e tij për mosinkriminimin e vetvetes përcaktuar në nenin 30(6) të Kushtetutës dhe nenin 6(1) të Konventës. Sikurse është shprehur Dhoma në *Vendimin mbi referimin e Mahir Hasanit*, këto të drejta janë standarde të pranuar ndërkombëtarisht në procedura penale dhe janë në gjenezën e parimit të procedurës së drejtë.<sup>35</sup>

53. Në lidhje me sa më lart, Dhoma vëren se rregulla 42 me formulimin aktualisht në fuqi, parashikon të drejtat e lartpërmendura. Në veçanti, kjo rregull përcakton se një person “nuk detyrohet të inkriminojë vetveten ose të pranojë fajësinë”. Ndryshimet e kësaj dispozite përmbajnë një hollësi të re, përkatësisht se një person “nuk detyrohet të pranojë fajësinë e [...] të dëshmojë kur dëshmia mund të inkriminojë atë apo personat e përmendur në rregullën 152”. (theksimi i shtuar) Megjithëse ky formulim edhe më tej parashikon të drejtën për të heshtur dhe të drejtën për mosinkriminimin e vetvetes, ai përcakton se këto të drejta zbatohen vetëm në rast se

<sup>34</sup> *Vendim mbi referimin e Mahir Hasanit*, para. 29-30; ECtHR/GJEDNJ, *Ibrahim and Others v. the United Kingdom* [GC], nr. 50541/08 dhe 3 të tjerë, 13 shtator 2016, para. 249.

<sup>35</sup> *Vendim mbi referimin e Mahir Hasanit*, para. 27; ECtHR/GJEDNJ, *Saunders v. the United Kingdom*, 17 dhjetor 1996, Raporte Aktgjykimesh dhe Vendimesh 1996-V, para. 68.

dëshmia 'mund të inkriminojë' personin. Për këtë arsye, Dhoma do ta shqyrtojë këtë aspekt specifik.

## 2. Vlerësimi i Dhomës

54. Dhoma rithekson se e drejta për mosinkriminimin e vetvetes kryesisht ka të bëjë me respektimin e vullnetit të personit 'të akuzuar për vepër penale', brenda kuptimit të nenit 30 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës,<sup>36</sup> për të heshtur. Kjo e drejtë nuk zbatohet lidhur me përdorimin në procese penale të materialit që mund të sigurohet nga një person i tillë përmes ushtrimit të kompetencave detyruese, por që ekziston pavarësisht nga vullneti i të akuzuarit, si për shembull për dokumentet që sigurohen nëpërmjet një urdhri.<sup>37</sup>

55. Në të njëjtën kohë, e drejta për mosinkriminimin e vetvetes logjikisht nuk mund të kufizohet vetëm në deklarata të pranimit të keqbërjes ose në komente që janë drejtpërdrejtë inkriminuese. Dëshmia që sigurohet nën detyrim dhe që në shikim të parë duket se nuk është e natyrës inkriminuese – si për shembull deklaratat shfajësuese apo thjesht informacioni për aspekte faktike – më vonë mund të përdoret në proces penal në mbështetje të akuzave të prokurorisë, për shembull për të kundërshtuar ose vënë në dyshim deklarata të tjera të të akuzuarit apo dëshmi të dhënë prej tij gjatë gjykimit, ose ndryshe për të diskredituar besueshmërinë e tij. Nga kjo rrjedh se në këtë kontekst ka rëndësi thelbësore se për çfarë do të përdoret dëshmia e siguruar nën detyrim në një gjykim penal.<sup>38</sup>

56. Në përputhje me sa më lart, lidhur me formulimin "mund të inkriminojë" në paragrafin e ndryshuar (1)(a) të rregullës 42, Dhoma nënvizon se ky formulim ka të

---

<sup>36</sup> *Vendim mbi referimin e Mahir Hasanit*, para. 29-30.

<sup>37</sup> Po aty, para. 33, 48; ECtHR/GJEDNJ, *Saunders v. the United Kingdom*, cituar më lart, para. 69.

<sup>38</sup> *Ibrahim and Others v. the United Kingdom* [GC], cituar më lart, para. 268-269; *Saunders v. the United Kingdom*, cituar më lart, para. 71.

bëjë jo vetëm me deklarata që janë drejtpërdrejtë inkriminuese, por edhe me deklarata të tjera që më pas përdoren në një mënyrë që synon të inkriminojë të akuzuarin.

### 3. Konstatim

57. Në varësi të respektimit të parimeve të shtjelluara më lart dhe duke mbajtur parasysh detyrimin e Dhomave të Specializuara për të funksionuar në përputhje me nenin 162(2) të Kushtetutës dhe nenin 3(2) të Ligjit, Dhoma konstaton se ndryshimet e rregullës 42 janë në përputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.

#### D. NDRYSHIMET E RREGULLAVE 56 DHE 57

58. Në rregullat e ndryshuara 56 dhe 57, ashtu sikurse i janë parashtruar Dhomës për shqyrtim, lexohet si vijon:

#### **Rregulla 56 Dispozita të përgjithshme mbi paraburgimin ~~Mbajtja në paraburgim~~**

(1) <sup>1</sup>Personi i cili është objekt i një urdhri për paraburgim, mbahet në paraburgim në përputhje me nenin 41(7) të Ligjit. <sup>2</sup>Në rrethana të jashtëzakonshme, personi në fjalë mund të mbahet në paraburgim në një objekt jashtë shtetit pritës apo jashtë Kosovës, deri në transferimin e tij. <sup>3</sup>Në rrethana të tilla, me kërkesë të një pale dhe pas këshillimeve me Administratorin, paneli mund të kërkojë modifikimin e kushteve të paraburgimit ose të shprehë mendimin në lidhje me kushtet e paraburgimit. <sup>4</sup>Gjatë gjithë kohës, personi i paraburgosur është nën juridiksionin e Dhomave të Specializuara.

(2) ~~<sup>1</sup>Para caktimit të gjykatësit të procedurës paraprake sipas nenit 33(1)(a) të Ligjit, vlerësimin e paraburgimit e bën gjykatësi i vetëm i caktuar në përputhje me nenin 33(2) të Ligjit, çdo dy (2) muaj ose më herët, me kërkesë të të dyshuarit apo të Prokurorit të Specializuar, ose *proprio motu*. <sup>2</sup>Përveç arsyeve të përcaktuara në nenin 41(6) të Ligjit, çdo kërkesë për mbajtje të mëtejshme në paraburgim duhet të përligjet prej masave hetimore që do të ndërmerren prej Prokurorit të Specializuar. <sup>3</sup>Paraburgimi sipas kësaj dispozite nuk mund të zgjasë më shumë se një (1) vit. <sup>4</sup>Me përfundimin e kësaj periudhe, dhe në qoftë se gjykatësi i procedurës paraprake ende nuk është caktuar, i dyshuari lirohet nga paraburgimi. Paneli siguron që një person të mos mbahet në paraburgim për një periudhë të paarsyeshme para hapjes së çështjes. Në rast vonese të paarsyeshme të shkaktuar nga Prokurori i Specializuar, pasi të ketë dëgjuar palët, paneli mund ta lirojë personin me kushte që i gjykon të përshtatshme.~~

(3) Me kërkesë të një të paraburgosuri, ose *proprio motu*, paneli mund të urdhërojë lirimin e përkohshëm të të paraburgosurit, kur ky lirim përlligjet prej arsyeve humanitare bindëse.

(4) I paraburgosuri nuk lirohet në shtetin e tretë pa pëlqimin e atij shteti.<sup>1</sup> Paneli dëgjon mendimin e shtetit të tretë në të cilin i paraburgosuri kërkon të lirohet.<sup>2</sup> Vendimi merret sa më shpejt që të jetë e mundshme dhe jo më vonë se tri (3) ditë pas parashtrimit të fundit.

(5) Paneli mund të caktojë kushte që i gjykon të përshtatshme për lirimin, për të garantuar praninë e të paraburgosurit ~~e të akuzuarit gjatë procesit gjyqësor, në përputhje me nenin 41(12) të Ligjit.~~

(6) Pa cenuar nenin 21(4)(c) të Ligjit, në bazë të një kërkesë ose *proprio motu*, dhe me qëllim mbrojtjen e dëshmitarëve apo viktimave, të informacionit konfidencial apo të integritetit të procesit, paneli mund të nxjerrë vendim lidhur me kushtet e paraburgimit dhe çështje që kanë lidhje me paraburgimin, ndër të tjera vendim mbi përcaktimin e kufizimeve të nevojshme dhe proporcionale mbi komunikimet e të paraburgosurit.

#### Rregulla 57 Rivlerësimi dhe rishikimi i mbajtjes në paraburgim

(1) **[SHËNIM – në versionin e mëparshëm rregulla 56(2)]** <sup>1</sup>Para caktimit të gjykatësit të procedurës paraprake sipas nenit 33(1)(a) të Ligjit, rivlerësimin e mbajtjes në paraburgim të një të dyshuari e bën gjykatësi i vetëm i caktuar në përputhje me nenin 33(2) të Ligjit, çdo dy (2) muaj ose më herët, me kërkesë të të dyshuarit apo të Prokurorit të Specializuar ose *proprio motu*, **nëse që nga vlerësimi i fundit ka ndryshim të rrethanave.** <sup>2</sup>Krahas arsyeve të përcaktuara në nenin 41(6) të Ligjit, çdo kërkesë për mbajtje të mëtejshme në paraburgim duhet të përlligjet prej masave hetimore që do të ndërmerren prej Prokurorit të Specializuar. <sup>3</sup>Paraburgimi sipas kësaj dispozite nuk mund të zgjasë më shumë se një (1) vit. <sup>4</sup>Me përfundimin e kësaj periudhe, nëse gjykatësi i procedurës paraprake ende nuk është caktuar, i dyshuari lirohet nga paraburgimi.

~~(1 2)~~ <sup>1</sup>Pas caktimit të gjykatësit të procedurës paraprake sipas nenit 33(1)(a) të Ligjit, dhe deri sa aktgjykimi të marrë formë të prerë, paneli i angazhuar me çështjen vlerëson vendimin mbi mbajtjen në paraburgim, pasi të kenë kaluar dy (2) muaj nga vendimi i fundit në lidhje me paraburgimin, në përputhje me nenin 41(10), (11) dhe (12) të Ligjit **ose në çdo kohë me kërkesë të të akuzuarit ose Prokurorit të Specializuar, ose *proprio motu*, nëse që nga vlerësimi i fundit ka ndryshim të rrethanave.** <sup>2</sup>Paneli siguron që një person të mos mbahet në paraburgim për një periudhë të paarsyeshme para hapjes së çështjes. <sup>3</sup>Në rast vonese të paarsyeshme të shkaktuar nga Prokurori i Specializuar, pasi të ketë dëgjuar palët, paneli mund lirojë personin me kushte që i gjykon të përshtatshme.

~~(2) Në rast të zbulimit të fakteve të reja të cilat e bëjnë të paligjshme mbajtjen e mëtejshme në paraburgim të një personi, personi në fjalë mund t'i kërkojë trupit gjykues që ka nxjerrë vendimin për mbajtjen e tij në paraburgim, rishqyrtimin e vendimit përkatës.~~

~~(3-2) Në qoftë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme të cilat përligjin lirim-in e personit të paraburgosur, në varësi të nenit 41(6) të Ligjit, me kërkesë të personit të paraburgosur ose proprio motu, dhe pasi t'i ketë dëgjuar parashtrimet e palëve, trupi gjykues mund të urdhërojë lirim-in e personit në cilëndo fazë të procesit gjyqësor.~~

~~(4) <sup>1</sup>Në bazë të një kërkesë sipas paragrafëve (2) ose (3), trupi gjykues mund të përcaktojë kushte të lirim-it që i gjykon të përshtatshme për të garantuar praninë e të akuzuarit gjatë procesit gjyqësor, në përputhje me nenin 41(12) të Ligjit. <sup>2</sup>Trupi gjykues dëgjon parashtrimet e një shteti të tretë në qoftë se personi i paraburgosur kërkon të lirohet në territorin e atij shteti. <sup>3</sup>Personi i paraburgosur nuk lirohet në territorin e shtetit të tretë pa pëlqimin e atij shteti. <sup>4</sup>Vendimi merret sa më shpejt që të jetë e mundshme dhe jo më vonë se tri (3) ditë pas parashtrimit të fundit.~~

## 1. Reflektime paraprake

59. Për sa u përket ndryshimeve të rregullave 56 dhe 57, Dhoma rikujton konstatimet e saj në Aktvendimet e 26 prillit 2017 dhe 28 qershorit 2017 se këto dispozita për paraburgimin lidhen me të drejtën themelore për liri të garantuar në nenin 29 të Kushtetutës dhe nenin 5 të Konventës.<sup>39</sup>

60. Dhoma më tej vëren se këto ndryshime nuk ndryshojnë në masë të konsiderueshme thelbin e dispozitave aktualisht në fuqi, të cilat Dhoma tashmë ka konstatuar se janë në përputhje me Kapitullin II të Kushtetutës. Rrjedhimisht, vlerësimi i Dhomës do të përqendrohet në disa aspekte që kërkojnë analizë më të imtë.

## 2. Vlerësimi i Dhomës

### (a) Periudha e paraburgimit

61. Dhoma vëren se sipas ndryshimeve, kriteri që paneli “të sigurojë që një person të mos mbahet në paraburgim për një periudhë të paarsyeshme para hapjes së çështjes” është zhvendosur nga paragrafi (2) i rregullës 57 në paragrafin (2) të rregullës 56. Dhoma gjithashtu vëren se rregulla 56 ashtu sikurse është ndryshuar, titullohet ‘Dispozita të përgjithshme mbi paraburgimin’. Ndonëse ky titull sugjeron

<sup>39</sup> Aktvendimi i 26 prillit 2017, para. 109, 112; Aktvendimi i 28 qershorit 2017, para. 94.

se në rregullën 56 përcaktohen kriteret e përgjithshme për paraburgimin, në paragrafin (2) të kësaj rregulle, detyrimi i panelit për të garantuar që periudha e kaluar në paraburgim të jetë e arsyeshme konkretisht lidhet vetëm me periudhën “para hapjes së çështjes”.

62. Në këtë kontekst, Dhoma rithekson se gjatë përcaktimit të kohëzgjatjes së paraburgimit në pritje të gjykitimit në kuadër të nenit 29(2) të Kushtetutës dhe nenit 5(3) të Konventës, periudha që duhet marrë parasysh fillon në ditën kur i akuzuari paraburgoset dhe përfundon në ditën kur i akuzuari lirohet ose kur merret vendim mbi akuzën, madje edhe vetëm nga një panel i shkallës së parë.<sup>40</sup> Për më tepër, neni 29(2) i Kushtetutës dhe neni 5(3) i Konventës nuk mund të interpretohen si autorizim i pakushtëzuar i masës së mbajtjes në paraburgim, me kusht që paraburgimi të zgjasë jo më shumë se një periudhë e caktuar minimale. Paneli duhet të arsyetojë bindshëm përligjen e çfarëdo periudhe të mbajtjes në paraburgim<sup>41</sup>

63. Në përputhje me sa më lart, Dhoma nënvizon se paragrafi (2) i ndryshuar i rregullës 56 për ‘Dispozitat e përgjithshme mbi paraburgimin’ nuk duhet të interpretohet i shkëputur nga parimet e përgjithshme të lartpërmendura. Rrjedhimisht, kjo nuk kufizon në asnjë mënyrë detyrimin e përgjithshëm të panelit për të garantuar se periudha e mbajtjes në paraburgim është e arsyeshme, duke përfshirë edhe pas hapjes së çështjes.

(b) Rivlerësimi dhe rishikimi i mbajtjes në paraburgim

64. Dhoma vëren se paragrafët (1) dhe (2) të rregullës 57 ashtu sikurse janë ndryshuar, parashikojnë rivlerësimin dhe rishikimin e masës së mbajtjes në paraburgim para dhe pas caktimit të gjykatësit të procedurës paraprake, pas

<sup>40</sup> ECtHR/GJEDNJ, *Buzadji v. the Republic of Moldova* [GC], nr. 23755/07, 5 korrik 2016, para. 85; *Velečka and Others v. Lithuania*, nr. 56998/16 dhe 3 të tjerë, 26 mars 2019, para. 95; *Štorčeký v. Slovakia*, nr. 55844/12, 5 qershor 2018, para. 55; *Solmaz v. Turkey*, nr. 27561/02, 16 janar 2007, para. 23-24.

<sup>41</sup> Shih Aktvendimin e 26 prillit 2017, para. 113-115; ECtHR/GJEDNJ, *Idalov v. Russia* [GC], nr. 5826/03, 22 maj 2012, para. 140; *Belchev v. Bulgaria*, nr. 39270/98, 8 prill 2004, para. 82; *Smirnova v. Russia*, nr. 46133/99 dhe 48183/99, ECHR 2003-IX, para. 62.

parashtrimin të një aktakuze. Nuk del në pah ndonjë ndryshim thelbësor i këtyre dispozitave. Po ashtu, Dhoma vëren se në fund të fjalisë së parë të këtyre dispozitave, është shtuar një frazë që lidh rivlerësimin dhe rishikimin e mbajtjes në paraburgim me “që nga vlerësimi i fundit ka ndryshim të rrethanave”.

65. Në këtë kontekst, Dhoma rikujton se në Aktvendimin e 26 prillit 2017, ajo nënvizoi rëndësinë e ligjshmërisë procedurale dhe materiale të paraburgimit në kuadër të nenit 29 të Kushtetutës dhe nenit 5 të Konventës.<sup>42</sup> Dhoma rithekson se për të qenë i ligjshëm në kuptimin e nenit 29 të Kushtetutës dhe nenit 5 të Konventës, paraburgimi duhet të kryhet në përputhje me dispozitat e zbatueshme materiale dhe procedurale.<sup>43</sup>

66. Duke qenë se fraza e re “ndryshim të rrethanave” lidhet me rivlerësimin dhe rishikimin e masës së mbajtjes në paraburgim, dispozita përkatëse e Ligjit që duhet të merret parasysh në mënyrë që paraburgimi të jetë i ligjshëm është neni 41(10). Dhoma veçanërisht thekson se neni 41(10) i Ligjit parashikon rivlerësimin dhe rishikimin e masës së paraburgimit çdo dy muaj “[d]eri në kohën kur aktgjykimi të marrë formën e prerë ose deri në lirimin nga paraburgimi”. Ky nen gjithashtu përcakton se një rivlerësim dhe rishikim i tillë është i duhur për “zgjatjen” e paraburgimit. Rrjedhimisht, me kalimin e dy muajve, personi përkatës duhet të lirohet, përveçse kur paneli kompetent merr vendim për zgjatjen e paraburgimit edhe për dy muaj të tjerë.<sup>44</sup>

67. Duke mbajtur parasysh sa më lart, fraza “ndryshim të rrethanave” në formulimin e ri të paragrafëve (1) dhe (2) të rregullës 57 ka të bëjë me rivlerësimin dhe rishikimin e masës së mbajtjes në paraburgim në mes periudhave prej dy muajsh “me

---

<sup>42</sup> Aktvendimi i 26 prillit 2017, para. 198.

<sup>43</sup> Shih ECtHR/GJEDNJ, *El-Masri v. the former Yugoslav Republic of Macedonia* [GC], nr. 39630/09, ECHR 2012, para. 230; *Baranowski v. Poland*, nr. 28358/95, ECHR 2000-III, para. 51.

<sup>44</sup> Lidhur me këtë, shih ECtHR/GJEDNJ, *Tase v. Romania*, nr. 29761/02, 10 qershor 2008, para. 40-41; *Smirnova v. Russia*, cituar më lart, para. 58-59.

kërkesë të të dyshuarit [ose të akuzuarit] ose Prokurorit të Specializuar, ose proprio motu". Ky rivlerësim dhe rishqyrtim garanton vlerësimin e faktorëve të rinj të rëndësishëm që mund të paraqiten në periudhën midis dy rivlerësimeve të paraburgimit, sidomos kur faktorë të tillë mund të ndikojnë në ligjshmërinë ose përligjjen e mbajtjes së mëtejshme të të akuzuarit në paraburgim.

68. Për sa i përket rivlerësimit dhe rishikimit të masës së mbajtjes në paraburgim çdo dy muaj, neni 41(10) i Ligjit lë të kuptohet se ky rivlerësim është automatik. Gjithashtu, rivlerësimi duhet të bëhet lidhur me periudhën e paraburgimit para dhe pas caktimit të gjykatësit të procedurës paraprake, pas parashtrimit të aktakuzës. Sikurse theksohet më lart, neni 41(10) i Ligjit parashikon kryerjen e rivlerësimit "[d]eri në kohën kur aktgjykimi të marrë formën e prerë ose deri në lirim nga paraburgimi", ku përfshihet edhe periudha e paraburgimit para caktimit të gjykatësit të procedurës paraprake.

(c) Kushtet lidhur me lirim

69. Në lidhje me ndryshimet e rregullave 56 dhe 57, Dhoma vëren se, sikurse vetë rregullat përkatëse aktualisht në fuqi, edhe ndryshimet parashikojnë mundësinë që një panel "të caktojë kushte që i gjykon të përshtatshme për lirim, për të garantuar praninë e të paraburgosurit" sikurse përcaktohet në rregullën e ndryshuar 56(5). Mundësia e lirit të një personi me kushtet që gjykohen të përshtatshme është ruajtur edhe në rregullën e ndryshuar 56(2).

70. Në të vërtetë, neni 41(12) i Ligjit parashikon një sërë masash më të buta që mund të urdhërohen për të siguruar praninë e të akuzuarit gjatë procesit gjyqësor, për të parandaluar përsëritjen e kryerjes së veprës penale ose për të garantuar zhvillimin e suksesshëm të procesit penal. Ndër këto masa përfshihen arresti shtëpiak dhe premtimi për moslargim nga vendbanimi. Në fakt, sikurse theksoi Dhoma në Aktvendimin e 26 prillit 2017, për të qenë plotësisht në përputhje me standardet



kushtetuese, gjatë marrjes së vendimit nëse një person duhet të paraburgoset, paneli duhet të marrë parasysh masa më të buta.<sup>45</sup>

71. Sikurse theksoi Dhoma në Aktvendimin e 26 prillit 2017, pavarësisht nga detyrimi i një paneli për të shqyrtuar masa të tjera më të buta, Rregullorja nuk përmbante asnjë dispozitë se si do të zbatoheshin masa të tilla.<sup>46</sup> Dhoma vëren se Rregullorja ashtu sikurse është ndryshuar, përsëri nuk përmban asnjë dispozitë të tillë. Lidhur me këtë aspekt, Dhoma vëren se në dallim nga Rregullorja, KPPK-ja përmban dispozita të hollësishme se si zbatohen masat e tjera më të buta. Në veçanti, pjesa 3 e kapitullit X përfshin dispozita lidhur me, për shembull, dorëzanimin në nenet 179-182, arrestin shtëpiak në nenin 183, dhe ndalimin për t'iu afruar një vendi apo personi të caktuar në nenin 177.

72. Është me rëndësi se neni 162(6) i Kushtetutës parashikon që “[d]homat e specializuara mund t’i përcaktojnë Rregullat e veta të Procedurës dhe Provave [...] dhe të udhëzuara nga Kodi i Procedurës Penale [të Kosovës]”.<sup>47</sup> Edhe neni 19(2) i Ligjit parashikon që “[n]ë përcaktimin e Rregullave të Procedurës dhe Provave, Dhomat e Specializuara drejtohen nga Kodi i Procedurës Penale të Kosovës 2012, Ligji Nr. 04/L-123”. Pavarësisht nga kushti që Dhomat e Specializuara të udhëzohen nga KPPK-ja, ndryshe nga KPPK-ja, Rregullorja nuk përmban dispozita se si duhen zbatuar masat më të buta.

73. Për më tepër, Dhoma vë në dukje se zbatimi i masave më të buta mund të lidhet me disa të drejta dhe liri themelore, si për shembull e drejta për liri në bazë të nenit 29 të Kushtetutës dhe nenit 5 të Konventës në rast të arrestit shtëpiak,<sup>48</sup> ose liria e lëvizjes

<sup>45</sup> Aktvendimi i 26 prillit 2017, para. 114. Shih ECtHR/GJEDNJ, *Buzadji v. the Republic of Moldova* [GC], cituar më lart, para. 87 *in fine*; *Idalov v. Russia*, cituar më lart, para. 140; *Jablonski v. Poland*, nr. 33492/96, 21 dhjetor 2000, para. 83.

<sup>46</sup> Aktvendimi i 26 prillit 2017, para. 116.

<sup>47</sup> Shih Aktvendimin e 28 qershorit 2017, para. 75.

<sup>48</sup> Shih ECtHR/GJEDNJ, *Buzadji v. the Republic of Moldova* [GC], cituar më lart, para. 103-104; *Süveges v. Hungary*, nr. 50255/12, 5 janar 2016, para. 77; *Lavents v. Latvia*, nr. 58442/00, 28 nëntor 2002, para. 63.

në bazë të nenit 35 të Kushtetutës dhe nenit 2 të Protokollit nr. 4 të Konventës në rast të masave për kufizimin e lëvizjes së një personi.<sup>49</sup>

74. Që ndërhyrja në të drejtat dhe liritë themelore të jetë në përputhje me Kushtetutën, ajo duhet të plotësojë standardet kushtetuese përkatëse. Këto mund të përfshijnë disa kushte që lidhen me cilësinë e ligjit, ndër të tjera me disponueshmërinë dhe parashikueshmërinë e tij.<sup>50</sup> Duke qenë se Rregullorja nuk përmban dispozita të hollësishme mbi zbatimin e masave më të buta, duhet të garantohet se zbatimi i masave më të buta nuk do të çojë në ndërhyrje që nuk është në përputhje me Kushtetutën dhe që lidhet me të drejtat e garantuara me Kushtetutë. Për të përmbushur plotësisht standardet kushtetuese në një rast të tillë, mund të jetë e nevojshme që paneli gjithashtu të marrë parasysh kushtet përkatëse të përcaktuara në nenin 41(12) ose nenin 41(6) të Ligjit, sipas rastit.<sup>51</sup>

### 3. Konstatim

75. Në varësi të respektimit të parimeve të shtjelluara më lart dhe duke mbajtur parasysh detyrimin e Dhomave të Specializuara për të funksionuar në përputhje me nenin 162(2) të Kushtetutës dhe nenin 3(2) të Ligjit, Dhoma konstaton se ndryshimet e rregullave 56 dhe 57 janë në përputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.

#### E. NDRYSHIMET E RREGULLËS 143

76. Në rregullën 143 të ndryshuar, ashtu sikurse i është parashtruar Dhomës për shqyrtim, lexohet si vijon:

#### **Rregulla 143                      Marrja në pyetje e dëshmitarëve**

(1) [I pandryshuar]

<sup>49</sup> Shih ECtHR/GJEDNJ, *Buzadji v. the Republic of Moldova* [GC], cituar më lart, para. 103; *De Tommaso v. Italy* [GC], nr. 43395/09, 23 shkurt 2017, para. 88-91. Shih gjithashtu Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Valon Bislimi kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë*, KI 06/10, Aktgjykim, 22 shtator 2010 (30 tetor 2010), para. 63-67.

<sup>50</sup> Shih, për shembull, ECtHR/GJEDNJ, *De Tommaso v. Italy* [GC], cituar më lart, para. 104-109.

<sup>51</sup> Shih, për shembull, ECtHR/GJEDNJ, *Buzadji v. the Republic of Moldova* [GC], cituar më lart, para. 113.

(2) Me autorizim të trupit gjykues, pala thirrëse e një dëshmitari mund ta pyesë dëshmitarin për sa më poshtë në qoftë se ka lidhje me besueshmërinë e dëshmitarit:

(a) [I pandryshuar];

(b) [I pandryshuar]; dhe

(c) nëse dëshmitari ka dhënë në çfarëdo kohe një deklaratë të mëhershme mospërputhëse. **Çdo deklaratë e tillë mospërputhëse mund të jetë e pranueshme për vlerësimin e besueshmërisë së dëshmitarit si edhe vërtetësinë e përmbajtjes së saj, ose për qëllime të tjera sipas gjykimit të trupit gjykues.**

(3) – (4) [të pandryshuar]

77. Ndryshimet e paragrafit 2(c) të rregullës 143 kanë të bëjnë me pranimin si provë të deklaratave të mëhershme mospërputhëse të dëshmitarëve. Ka shumë të ngjarë që një deklaratë e tillë të jetë dhënë në mungesën e të akuzuarit. Lidhur me këtë, Dhoma rikujton se në bazë të nenit 31(4) të Kushtetutës dhe nenit 6(3)(d) të Konventës, një person i akuzuar për veprë penale ka të drejtë t’u bëjë pyetje dëshmitarëve që dëshmojnë kundër tij. Kjo e drejtë është një aspekt specifik i të drejtës për gjykim të drejtë përcaktuar në nenin 31(2) të Kushtetutës dhe nenin 6(1) të Konventës, i cili duhet të mbahet parasysh gjatë vlerësimit të drejtësisë së procesit.<sup>52</sup>

78. Dhoma më tej rithekson se të gjitha provat normalisht duhet të prezantohen në prani të të akuzuarit në seancë publike, me qëllim të ballafaqimit. Megjithatë, përdorimi si provë i deklaratave të marra në faza të tjera të procesit, përfshirë gjatë fazës së hetimit, në vetvete nuk është në mospërputhje me nenin 31(2) dhe (4) të Kushtetutës dhe nenin 6(1) dhe (3)(d) të Konventës, në qoftë se të drejtat e mbrojtjes janë respektuar. Si rregull, këto të drejta kushtëzojnë që të akuzuarit t’i jepet mundësi e përshtatshme dhe e mjaftueshme për të kundërshtuar dëshmitarin që dëshmon

<sup>52</sup> ECtHR/GJEDNJ, *Schatschaschwili v. Germany* [GC], nr. 9154/10, ECHR 2015, para. 100; *Al-Khawaja and Tahery v. the United Kingdom* [GC], nr. 26766/05 dhe 22228/06, ECHR 2011, para. 118; *Lucà v. Italy*, nr. 33354/96, ECHR 2001-II, para. 37-38. Shih *Vendim mbi kërkesën referuese të Driton Lajçit*, para. 14, 21.

kundër tij dhe për t'i bërë pyetje atij dëshmitari ose në kohën kur ai jep deklaratën, ose në një fazë të mëvonshme të procesit.<sup>53</sup>

79. Nga kjo rrjedh se në qoftë se i akuzuari nuk ka pasur mundësinë e duhur dhe të mjaftueshme për të kundërshtuar dhe pyetur dëshmitarin në kohën kur ai dëshmitar ka qenë duke dhënë deklaratën e përmendur në rregullën e ndryshuar 143(2)(c), si rregull i përgjithshëm të akuzuarit duhet t'i jepet një mundësi e tillë në një fazë të mëvonshme të procesit. Dhoma vëren se kjo mundësi përcaktohet konkretisht në rregullën 143(3).

80. Për aq sa ndryshimet e rregullës 143(2)(c) kanë të bëjnë me mundësinë që një panel të pranojë si provë një deklaratë të mëhershme *mospërputhëse*, GJEDNJ-ja e ka bërë të qartë se për shpalljen e një të akuzuari fajtor, një gjykatë mund të përdorë deklaratat që ka dhënë një dëshmitar gjatë fazës hetimore dhe të cilat i ka tërhequr më pas në gjykim, me kusht që mbrojtja të ketë pasur mundësinë t'i bëjë pyetje atij dëshmitari në gjykim. Në të vërtetë, nuk mund të nxirret përfundim abstrakt se çdo herë duhet mbështetur në dëshminë e një dëshmitari të dhënë në gjykim dhe nën betim kundrejt një deklaratë të po atij dëshmitari të dhënë gjatë procedimit penal, madje edhe kur këto të dyja janë kundërthënëse. Është paneli ai që duhet të vlerësojë besueshmërinë e dëshmitarit dhe të bëjë zgjedhjen midis dy versioneve konkurrenente të së vërtetës, me kusht që të jetë respektuar standardi kushtetues i gjykimit të drejtë.<sup>54</sup>

81. Duke mbajtur parasysh vërejtjet e mësipërme, Dhoma konstaton se ndryshimet e rregullës 143 janë në përputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.

---

<sup>53</sup> Shih Aktvendimin e 26 prillit 2017, para. 189; ECtHR/GJEDNJ, *Schatschaschwili v. Germany* [GC], cituar më lart, para. 103, 105; *Al-Khawaja and Tahery v. the United Kingdom* [GC], cituar më lart, para. 118; *Lucà v. Italy*, cituar më lart, para. 39-40.

<sup>54</sup> ECtHR/GJEDNJ, *Camilleri v. Malta*, nr. 51760/99, 16 maj 2000. Shih gjithashtu ECtHR/GJEDNJ, *Bosti v. Italy* (dec.), nr. 43952/09, 13 nëntor 2014, para. 35-47; *Berardi and Others v. San Marino* (dec.), nr. 24705/16, 24818/16 dhe 33893/16, 1 qershor 2017, para. 73-79.

## F. NDRYSHIMET E TJERA

82. Dhoma ka shqyrtuar ndryshimet e tjera të Rregullores për nga përputhshmëria e tyre me Kapitullin II të Kushtetutës, përkatësisht ndryshimet e rregullave 2, 16, 25, 27, 29, 43, 63, 65, 78, 79, 82, 85, 93, 94, 100, 101, 102, 113, 115, 125, 145, 151, 155, 208. Dhoma konstaton se këto ndryshime nuk ngrenë asnjë çështje që kërkon analizë më të hollësishme. Këto ndryshime ashtu sikurse janë formuluar, janë në përputhje me Kapitullin II, përfshirë nenin 55, të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, njëzëri,

1. *Deklaron* se Referimi është i pranueshëm;
2. *Vlerëson* se ndryshimet e rregullave 2, 16, 25, 27, 29, 31, 38, 42, 43, 56, 57, 63, 65, 78, 79, 82, 85, 93, 94, 100, 101, 102, 113, 115, 125, 143, 145, 151, 155, 208 janë në përputhje me Kapitullin II të Kushtetutës.

/nënshkrim/

**Vidar Stensland**  
**Kryegjykatës**

Hartuar në anglishte, e premte, 22 maj 2020

Në Hagë, Holandë